



Datë: 19.11.2025
Numër Protokolli: 7495/2025

A.nr.1196/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi - kryetare, Malsore Bajraktari Gashi, dhe Eshref Shaban, anëtarë, me Hava Fekaj, Zyrtare e Lartë për Hetim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1196/2025, të datës 23.06.2025, të parashtruar nga ankuesi, F.M, kundër organit të punësimit/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, më datë 19.11.2025 mori këtë;

V E N D I M

I. Aprobuhet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1196/2025, e datës 23.06.2025, e parashtruar nga ankuesi, F.M.

II. Anulohet në tërësi procedura e pranimit më numër të referencës RN00017323, pozita e punës Drejtor i Institutit Bujqësor – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

III. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet administrative për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet lidhur me zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi, F.M (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), me datë 23.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit më numër protokolli 1936, të datës 27.05.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur më shpalljen e kandidatit fitues në procedurën e pranimit më numër të referencës RN0001732, respektivisht për pozitën e punës Drejtor i Institutit Bujqësor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Pejë, ndërsa, kjo e fundit, ka deponuar përgjigje në pretendimet ankimore të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me nr. protokoli 4268/2025 e datës 23.06.2025; Diplomën e kandidatit A.O me Nr.61, Diplomën e kandidatit A.O, të Universitetit, ‘Haxhi Zeka’, në Pejë, Diplomën e Studimeve Pasdiplomike-Master, me Nr.295/15 të lëshuar nga Kolegji AAB, Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; E-mail i datës 26.05.2025; Vendimin e datës 08.05.2025; E-mail e datës 02.06.2025; Konkursi; Njoftimin e datës 30.04.2025; Lista e aplikantëve; Njoftimin për kandidatin fitues e datës 27.05.2025; Vendimin e datës 03.11.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.07.2025; Pasqyrën e trustit pensional; Dëshmi për marrëdhënien e punës të ankuesit në Ndërmarrjen NP, ‘Niki-S’; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës me Nr.prot 1196/2025 e datës 18.07.2025; Shpalljen e konkursit të datës 21.03.2025 me RN.00017323; Njoftimin e datës 30.04.2025 për fazën e verifikimi paraprak lista e kanidateve aplikues, lista e kanidateve te refuzuar dhe aprovuar; Vendimin nr.protokoli 1713, të datës 07.05.2025 mbi dhemelimin e komisionit të pranimit, Akt emërimit të Sh.Z e datës 13.12.2012; Akt emërimit të D.B e datës 12.02.2020; Akt emërimit të S.H e datës 10.12.2012; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt emërimit të S.H i datës 12.07.2019; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit të S.V i datës 05.02.2014; Vendimin për pushim të S.V’ Akt emërimit të N.M i datës 03.02.2014; Arovimin e datës 20.03.2025; Formulari i përshkrimit të punës i datës 20.03.2025; E-mail i datës 07.05.2025; Testet Individuale; Formularët e vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatëve nga komisioni i pranimit; Rezultati i testit me shkrim; E-mail e datës 20.05.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatë në intervistë e datës 20.05.2025; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 22.05.2025; Aplikacioni i F.M (ankuesit) i datës 07.04.2025 se bashku me dokumentacionin e aplikimit; Aplikacionin e kandidatit A.O i datës 16.04.2025 se bashku me dokumentacionin e aplikimit; Pasqyra e trustit Pensional; Certifikata mbi dënimet Penale; Vendimin me Nr. Protokoli 4622, i datës 03.11.2023; Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës të kandidatit fitues A.O i datës 14.04.2025; Kontratën e punësimit të Kandidatit fitues për periudhën kohore nga 01.11.2004 deri më 31.01.2005; Kontratën e punësimit të Kandidatit fitues për periudhën kohore nga 01.01.2005 deri më 31.12.2006; Kontratën e punësimit të Kandidatit fitues për periudhën kohore nga 01.01.2008 deri më 31.12.2010; Ndryshim plotësimin e Aktit të Emërimit me Nr. Protokoli 426 i datës 09.02.2017; Vërtetimin mbi Marrëdhënien e Punës i kandidatit fitues i datës 14.04.2025, për periudhën kohore nga data 01.11.2004 deri më 02.11.2023; Letër referencën; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatit fitues; Pasqyrën e Trusit Pensional, emaili i adtës 17.11.2025 nga Këshilli për NJBNJ të MBPZHR lidhur me strukturën e Institutit Bujqësore, emailin e datës 17 dhe 19 nëntor 2025 të NJBNJ të MBPZHR ne kërkesën e Këshillit të datës 17.11.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara, sepse:

Rrethanat e çështjes:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 21.03.2025 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00017323, për pozitën e punës Drejtor i Institutit Bujqësor, klasa e mesme drejtuese, me afat aplikimi 22.03.2025 deri më 20.04.2025.
- Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej gjashtë (6) kandidatë, ndër ta edhe ankuesi, i cila ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa, i njëjti i është nënshtruar edhe fazës së testimit me shkrim duke akumuluar gjithsej 45.4 pikë, pikë këto të pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit.
- Njësia e Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 27.05.2025, ka publikuar Njoftimin Nr. Protokoli 1936, nga i cili njoftim rezulton se si kandidati i suksesshme për procedurën përkatëse është shpallur A.O me 86.6 pikë.

- Ankuesi, pas publikimit të Njoftimit të datës 27.05.2025, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimin se kandidati A.O nuk ka plotësuar kriterin e arsimit. Shton se pyetjet e testit me shkrim dhe eseja nuk janë parashtruar nga fusha e njohurive, në listën e ngushtë janë përfshirë kandidatë që nuk e kanë përvojën e punës nga fusha për të cilën është zhvilluar procedura e rekrutimi dhe as përvojën e kërkuar. Shton se përbërja e komisionit të pranimit nuk ka qenë një nëpunës civil nga njësia përgjegjësi, dhe se gjatë testit me shkrim kanë qenë vetëm tre anëtarë Sh.Z, S.H dhe E.Z. Më tej, ankuesi pretendon se ka pas edhe parregullsi në testin me shkrim ashtu që pyetjet e testit nuk kanë të bëjnë me menaxhim dhe nuk janë të parashtruar në mënyrë të drejtë, po që ishin pyetje shumë teknike, në këtë kontekst, ankuesi veçon pyetjet nr. 3, 7, 2, 5, 4,15, të cilat sipas pyetja sipas ankuesit janë dhënë në atë mënyrë që të favorizojnë kandidatin fitues. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet njoftimi i datës 27.05.2025 për shpalljen e kandidatit fitues.

Vlerësimi i Kolegjit:

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen konkursit publik me numër reference RN00017323, për pozitën e punës “Drejtor i Institutit Bujqësor”, në Pejë, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: *Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Fakulteti i Bujqësisë, Drejtimi i përgjithshëm, pemëtari, vreshtari. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërin nga kërkesat në vijimin: 1.) tre (3) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose 2.) dy (2) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose 3.) një (1) vit përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës).*

Rrjedhimisht, në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale dhe klasifikimit të pozitës së kontestuar, Kolegji ka analizuar Rregulloren në fuqi (me rastin e shpalljes së konkursit) për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit, gjegjësisht, Rregulloren (QRK) NR.37/2013, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Instituti Bujqësor nuk parashihet si njësi organizative në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë dhe po ashtu kjo e fundit nuk ka nxjerr ndonjë akt të veçantë nënligjor që rregullon çështjen e funksionit dhe organizmit të Institutit Bujqësor.

Si pasojë, në mungesë të përcaktimit me rregullore të pozitës së kontestuar, Këshilli më datë 17.11.2025, i është drejtuar më kërkesë Njesisë Përgjegjëse në këtë ratë Njesisë së Personelit të MBPZHR-së për sqarim si vijon: *” Lidhur me ankesën për pozitën Drejtor në Institutin Bujqësor, Ju lutem na njoftoni se si është i organizuar ky institucion, a ka rregullore të brendshme, organogram apo akt tjetër për rregullimin e tij. Ndërsa, me datë 17.11.2025, Njësia e Personelit të MBPYHR-së ka ofruar sqarimin së: **Ju njoftojmë i Institutit Bujqësor i Kosovës në Pejë i themeluar në vitin 1947 është në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.2023/3 të bashkangjitur është përcaktuar Roli dhe mandati i tij. Ndërsa , në Rregulloren e brendshme aktuale për Sistematizimin e Vendeve të Punës nuk është e përfshirë. Është pjesë e rregullores së AUV, dhe ata janë duke punuar në këtë drejtim. Po ashtu është duke u punuar Koncepti dokumenti për Institutin Bujqësor të Kosovës (IBK). Instituti Bujqësor i Kosovës në Pejë ka linjën e veçantë buxhetore dhe numrin e caktuar të zyrtarëve të përfshirë 36 punëtor të cilët Menaxhohen nga MBPZHR dhe raportojnë për gjitha aktivitetet.** Kurse, më datë 19.11.2025, Këshilli ka pranuar*

sqarimin se: **Bazuar në kërkesën e juaj lidhur me pozitën e publikuar Drejtor i Institutit Bujqësor me lejon të shtoj se Instituti Bujqësor i Kosovës në Pejë është në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural . Sipas Vendimit të themeluar dhe nënshkruar nga Sekretarja e Përgjithshme grupi punues është duke punuar për hartimin e Koncept dokumentit për Institutin Bujqësor të Kosovës Pozita Drejtor i Institutit Bujqësor është publikuar sepse është e mbuluar me ushtrues detyre nga Zyrtari i Lartë (Profesional 1) të këtij institucioni sepse në IBK nuk ka pozita të ulëta drejtuese.**

Andaj, marrë për bazë sqarimet e organit punëdhënës, Kolegji ka analizuar Udhëzimin Administrativ Nr.2003/3 në fuqi më datë 18.06.2003, si pjesë e legjislacionit të UNMIK-ut ku vërtetohet se më këtë akt juridik është themeluar Instituti i Bujqësisë më seli në Pejë, ku janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tij (neni 1), rrjedhimisht, më nenin 1, nënpika 1.4 të këtij udhëzimi është përcaktuar se: **Roli i Institutit në kontrollin e kualitetit të ushqimit do të sqarohet tutje pasi të jetë krijuara Agjencia e Kontrollit të Ushqimit dhe qartë të jetë definuar roli i secilit institucion ..**” ndërsa, më nenin 4, pika 4.2 është paraparë se: **Instituti do të plotësoj personelin dhe organizohet në pajtim me nenin 5.4 të Rregullores se UNMIK-ut 2001/19.** Ne fakt, referuar kësaj bazë ligjore, Kolegji nuk ka arrit të vërtetohet se ekziston ndonjë akt tjetër që ka rregulluar organizmin e brendshëm të Institutit të Bujqësisë, dhe për pasojë as pas themelimit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë nuk ka ndonjë akt që rregullon organizmin dhe funksionimin e Institutit Bujqësor. Deri në këtë konstatim, Kolegji erdhi pas analizimit të legjislacionit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ku kjo e fundit që nga themelimi ka në fuqi Rregulloren Nr.01/2011 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, e zbatueshme nga data 26.03.2012, e më të cilën rregullore nuk është paraparë Instituti Bujqësor si njësi në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Andaj, bazuar në këto rrethana juridike dhe faktike, e më qëllim të kthimit të ligjshmërisë, Kolegji konstaton se shpallja e procedurës numër reference RN00017323, për pozitën e punës Drejtor i Institutit Bujqësor është e paligjshme në kuptim të nenit 52, paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Rrjedhimisht, një pozitë e lirë në shërbim civil mund të shpallët për plotësim vetëm nën rrethanat nëse pozita e tillë është e paraparë më rregullore të brendshme të institucionit dhe e miratuar nga ministria kompetente. Gjegjësisht, shpallja e pozitës së kontestuar vetëm mbi bazën e Udhëzimit Administrativ Nr.2003/3, është tërësisht e papranueshme ligjërisht, mbi faktin se ky udhëzim është i nxjerr në kohën e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës, dhe se legjislacioni për shërbim civil ka pasuar ndryshime të vazhdueshme lidhur me pranimin e nëpunësve civil.

Thënë si më lartë, e në mbështetje të nenit nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimit.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1196/2025

Hava FEKAJ

Procesmbajtëse

Ardita HAXHNIKA-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, F.M.;
- Njesisë së Personelit në Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.